



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/91
Datë: 26.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 115,740.00 (njëqind e pesëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e katër dhjetë) euro, për punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e kufirit Shtetëror, sipas kërkesës së Komisionit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Zyrën e Kryeministrit - 104, nën programi Kabineti i Kryeministrit 104-10700, në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/91
Datë: 26.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 25,170.00 (njëzetepesëmijë e njëqind e shtatëdhjetë) euro, për mbulimin e aktiviteteve që do të mbahen me rastin e Epopesë së UÇK-së në Dukagjin.
2. Mjetet financiare nga paragrafi 1. i këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, nën programi Kabineti i Kryeministrit 10700, në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime.
3. Mjetet financiare nga paragrafi 1. i këtij vendimi paguhet në llogarinë: OVL UÇK Gjakovë Banka Ekonomike 1402-00000-1758448.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit-Zyra për Çështjet e Kategorive të dala nga Lufta për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Ramush Haradinaj
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/91


Datë: 26.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare për 24 shoqatat e familjeve të personave të zhdukur, 5,000.00 (pesë mijë) euro për shoqatë, për përkrahje në funksionimin e tyre.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Zyrën e Kryeministrit, kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, kodi 10600.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/91


Datë: 26.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për kompensimin e shtesave dhe stimulim financiar për vitin 2019, në shumë prej 171,864 euro.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të rezervës dhe transferohen në Këshillin Prokurorial të Kosovës me kod 250 nën programi Prokuroria Speciale me kod 32200 kategoria e shpenzimeve Pagat dhe Mëditjet.
3. Obligohet Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/91
Datë: 26.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për nënshkrimin e Deklaratës së Qëllimit për ndërprerjen e Marrëveshjes për sigurime sociale në mes Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës, si Marrëveshje e marrë përsipër nga Republika e Kosovës me procesin e suksedimit të Marrëveshjeve Bilaterale të nënshkruara nga ish-RSFJ me shtetet tjera, në këtë rast Mbretëria e Holandës (Marrëveshja, e njohur si Konventa për sigurime shoqërore ndërmjet Mbretërisë së Holandës dhe RSFJ-së, e nënshkruar më 11 Maj 1977, hyrja në fuqi më 1 prill 1979 si dhe Marrëveshja Administrative në lidhje me modalitetet e zbatimit të Konventës për sigurim social, e nënshkruar më 16 maj 1977, hyrja në fuqi më 1 prill 1979).
2. Nënshkrimi i Deklaratës së Qëllimit, hap mundësitë për nisjen e negociatave për Marrëveshjen e re të Sigurimeve Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/91
Datë: 26.02.2019


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim të përhershëm dhe me krijimin e të drejtës së servitutit të detyrueshëm për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Parkut të Energjisë me Erë Selac" që përfshin ndërtimin e largpërçuesit 110kV, Nën stacioni Vushtrria 1-Nën stacioni Selac dhe nënstationi 33/110kV Selac zonat kadastrale: Vushtrri, Dobërllukë, Banjë, Gjëlbrishtë Sumë, Gunnishtë, Komuna e Vushtrrisë dhe zonat kadastrale Rashanë, Tërstenë, Bajgorë, Komuna e Mitrovicës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A).
4. Mjetet financiare për kompensimin e procedurës së shpronësimit, vlerësimit, kompensimin e pronave të pronarëve dhe obligimeve tjera ligjore dhe gjyqësore që rrjedhin sipas Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 janë të siguruar nga Kompania "Sowi Kosovo L.L.C" nën monitorimin dhe përgjegjësinë e Ndërmarrjes Publike KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë